**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**Komuna e Drenasit**
**Kuvendi i Komunës**

**Nr.** 02-060-3833 **dt.** 18.01 **2023**

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Gllogocit), nenit 3 pika 3.7 si dhe nenit 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Milaim Hajdari, më datë: **25.01.2023** (E Mërkure) duke filluar në ora **10:00** në sallën e Kuvendit të Komunës.

THËRRET
MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Mbledhja do të ketë këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt i Kuvendit Komunal Drenas të dt. 24.11.2022,dhe procesverbali i mbledhjes së Jashtëzakonshme i dt.28.12.2022.
2. Draft Propozim i Planit të Veprimit për vitin 2023-2024 të Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2020-2024 me ndryshim-plotësimin.
3. Propozim Vendim për miratimin e Simbolit Përkujtimor të Gjenocidit në Kosovë.
4. Raporti i përformancës të Komunës së Drenasit për vitin 2021.
5. Raporti vjetor i Komitetit për Komunitete dhe Kthim.
6. Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizua për vitin 2022.
7. Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për për Arsim Kulturë Rini dhe Sport për vitin 2022.
8. Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik Mbrojtje të Ambientit Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2022.
9. Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për Komiteti për Barazi Gjinore për vitin 2022.
10. Raporti financiar Janar Dhjetor 2022.
11. Të ndryshme.

Drenas, 18.01.2023

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Milaim Hajdari

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA GLLOGOC
GLLOGOC MUNICIPALITY
Pranuar 18 01 23
Nj. Org | Numër | Shtojca | Vlera
02 | 060- | 3833 |

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**Komuna e Drenasit**
**Zyra e Kuvendit**

**Rekomandimet e dhëna nga Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur me datë 18. 01.2022, si vijon.**

-Pasi kryesuesi përshëndeti të pranishmit njoftoi anëtarët e K. P. F-ca, për rendin e ditës, me një pikë shtesë, materiali ju është dorëzuar me kohë, ku i pyeti të pranishmit nëse ka dikush debat rreth pikave të rendit të ditës mundet me marr fjalën, diskutime nuk pati hodhi në votim rendin e ditës.

1. Raporti financiar Janar Dhjetor 2022.
   - **Votuan 07 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më dt. 17. 11.2022.
   - **Votuan 07 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**
2. Draft Propozim i Planit të Veprimit për vitin 2023-2024 të Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2020-2024 me ndryshim-plotësimin.
   - **Votuan 07 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**
3. Propozim Vendim për miratimin e Simbolit Përkujtimor të Gjenocidit në Kosovë.
   - **Votuan 07 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**
4. Raporti i përformancës të Komunës së Drenasit për vitin 2021.
   **- Rekomandohet për Kuvend.**
5. Raporti vjetor i Komitetit për Komunitete dhe Kthim.
   **- Rekomandohet për Kuvend.**
6. Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizua për vitin 2022.
   **- Rekomandohet për Kuvend.**
7. Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ Arsim Kulturë Rini dhe Sport. për vitin 2022.
   **- Rekomandohet për Kuvend.**
8. Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik Mbrojtje të Ambientit Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2022.
   **- Rekomandohet për Kuvend.**
9. Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për Komiteti për Barazi Gjinore për vitin 2022.
   **- Rekomandohet për Kuvend.**
10. Raporti financiar Janar Dhjetor 2022.
    **- Rekomandohet për Kuvend.**
11. Të ndryshme.

**-Pasi nuk pati diskutime mbledhja përfundoi në ora 11: 30.**

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Milaim Hajdari**

REPUBLIKA E KOSOVËS · KOMUNA GLLOGOC · REPUBLIC OF KOSOVO · MUNICIPALITY · REPUBLIKA KOSOVO · OPŠTINA GLLOGOC

Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës

02 Nr. 06 0/04-6445 dt. 15-12. 2022

# PROCESVERBALI

I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: **24.11.2022**

**Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Komunal-Milaim Hajdari**

**Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 29 anëtarë.**
Kuvendi filloi punimet më këtë :

**Rend dite:**

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt i Kuvendit Komunal Drenas të dt. 27.10.2022.
2. Draft Propozim Plani i Veprimit për vitin 2023-2024, të Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2020-2024.
3. Propozim Vendim për caktimin e normave tatimore për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2023.
4. **Propozim** Vendim për dhënien në shfrytëzim Afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të Pronës së Paluajtshme të Komunës të personit fizik juridik Limit Project shpk, "Rinesa" shpk në parcelën kadastrale : P-70314035-00004-124, zona kadastrale Komoran.
5. **Propozim** Vendim për dhënien në shfrytëzim Afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të Pronës së Paluajtshme të Komunës të personit juridik Mehdi Gjoka, B.I, "Fer Petrol" në parcelën kadastrale: P-70315052-00140-3, zona kadastrale Çikatovë e re.
6. **Propozim** Vendim për dhënien në shfrytëzim Afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të Pronës së Paluajtshme të Komunës të personit fizik Blerim Kluna në parcelen: P-70314035-01981-0, zona kadastrale Komoran.
7. **Propozim** Vendim për dhënien në shfrytëzim Afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të Pronës së Paluajtshme të Komunës të personit fizik Habib Miftari në parcelen kadastrale: P-70314016-00034-0, në zona kadastrale Korroticë e Eperme.
8. **Propozim** Vendim për dhënien në shfrytëzim Afatgjatë prej nëntëdhjetë nëntë (99) vite të Pronës së Paluajtshme të Komunës të personit juridik Rinesa Shpk- Ideal Partners shpk, BM Group, BM Group, Fer Petrol, Aktiv Residence me parcelën kadastrale: P-70315016-01032-2, zona kadastrale Gllogoc.
9. Raporti i përformancës të Komunës së Drenasit për vitin 2021.
10. Të ndryshme.

Të enjten me dt. 24.11.2022 është mbajtur mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Drenasit, ku për diskutim ishin 10 pika për rend dite.
Mbledhja është kryesuar nga kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari, ndërsa merrnin pjesë, kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, nënkryetari Arben Shala, drejtor të drejtorive komunale, anëtarët e Kuvendit, zyra e informimit, përfaqësues të KFOR-it, përfaqësues të Mediave, Mungoj Jahir Hajdari, Mërgim Pirraku, me arsyetim.

Më poshtë ju elaborojmë pikat që janë diskutuar e miratuar me shumicë votash në mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hadari**- pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit njoftoi me rendin e ditës anëtaret e Kuvendit Komunal.

**Azemine Gjoka Bujupi,** Të nderuar qytetar, sot jemi mbledhur këtu që të tregojmë se pse kemi marr besimin qytetar. Siç jeni të shqetësuar ju në këto momente , shqetësimi është edhe brenda secilit nga ne, sepse sot, po tentohet të grabitet prona e komunës.
Muaji nëntor është muaji ku janë gdhendur datat më të rëndësishme të historisë sonë më të lavdishme kombëtare, prandaj sot nuk bënë assesi që datën 24 nëntor ta kujtojmë si datën e turpit tonë, nëse veprojmë me logjikën grabitqare.
Sot kemi momentin të gjithë ne si asamblist, si të zgjedhurit e qytetareve, me e dëshmu se sa parësor është vendi ynë, komuna jonë.

Sot unë e gjithë ne, opozitë e pozitë, duhet me u qu edhe me dal prej seance.
Po, me u qu edhe me dal.
Nuk na falet ky moment nëse qëndrojmë e bëhemi kukulla për interesa të disa grabitqareve.
Nuk do na falet besoni, do të mbaheni mend me figura emër e mbiemër!
Ai'a vlen? Jo.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hadari,** diskutimi është për rendin e ditës, çështjen që po e ngrit mund ta diskutosh tek pika e rendit të ditës. Fjalimi e asambleistës Azemine Gjoka Bujupi u nderpe.

Pas diskutimeve që u dhanë, kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës: prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, **(Për)** votuan 20 anëtar, 9 vota kundër, abstenim nuk pati.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari,** hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: 1. **Procesverbali i mbledhjes të Kuvendit Komunal të dt. 27.10.2022.**

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime tjera kryesuesi hodhi në votim ketë pikë të rendin e ditës: prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, **(Për)** votuan 29 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua procesverbali.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari,** hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës. **2. Draft Propozim Plani i Veprimit për vitin 2023-2024, të Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2020-2024.**

**Egzona Jetullahu-Gjoshi, Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik**, para jush po e paraqes Plani i Veprimit për vitin 2023-2024, të Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2020-2024. Strategjia e zhvillimit ekonomik Lokal është projekt 5 vjeçar ndërsa plani i veprimit të saj ka qenë tre vjeçar ndërsa me rekomandime nga Ministria e Pushtetit Lokal dhe Ministria e

Financave është hartuar plani i veprimit për periudhën e mbetur dmth për dy vitet e fundit për vitet 2022-2024 të këtij dokumenti strategjik, ky plan i veprimit u hartua sipas vendimit të kryetarit të komunës me dt. 30.06.2022, ekipi komunal ka hartuar Draft-Planin e veprimit për këto vite i bazuar në dokumentin e strategjisë së zhvillimit ekonomik lokal. Plani i veprimit u hartua nga anëtaret e Ekipit Komunal të cilat i kanë inkorporuar të dhënat sipas fushave të drejtorive përkatëse të tyre. duhet të votohen objektivat vetëm për projektet të cilat janë të inkorporuar në strategjinë ë zhvillimit ekonomik lokal që është dokument strategjik 5 vjeçar ndërsa edhe projektet të cilat janë në periudhën 2024-2025 duhet të aprovohen me buxhetim.

**Egzona Tërdevci,** tek pika 1.3 përkatësisht 1.4 pjesëmarrja në konferenca investive se paku dy janë planifikuar 10,000 € nga donacionet, cilat janë këto konferenca, apo çfarë natyre janë këto konferenca? Po ashtu janë planifikuar 70 € nga donacioni për pjesën e hartimit të studimit të fizibilitetit për 3 projekte përmes partneritetit publiko privat, cilat projekte janë këto? Janë planifikuar nga mjetet vetanake 30 mijë euro për stimulim të eksportit mbështetje të 5 bizneseve në vit, a keni ndonjë analizë paraprake se cilat biznese në Drenas janë të orientuar në eksport dhe si do të mund t'i ndihmoni? Po ashtu tek tabela e planit strategjik dhe operacional mungon kostimi total se sa do t'i kushtoj buxhetit tonë dhe sa janë pritshmeritë nga donatoret.

**Egzona Jetullahu-Gjoshi, Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik,** projektet të cilat i ceke paraprakisht të gjitha janë të regjistruara në dokumentin e strategjisë të zhvillimit ekonomik-lokal dokument i cili është aprovuar nga legjistratura e kaluar dhe të gjitha dokumentet janë të publikuara edhe në ueb faqen e Komunës së Drenasit të gjitha janë më objektiva me kërkesa dhe me oferta të gjitha janë aty, kjo është vetëm për projektet ë cilat janë në vazhdimësi dhe të cilat do të realizohen janë shumë projektë të cilat ministria ka kërkuar që alokimi i këtyre mjeteve duhet të bëhet edhe për dy periudha që kane mbetur, nuk mund të ndryshojmë asgjë, ato të cilat janë të parapara në këtë stradegji e cila është punuar nga një ekip komunal nga ekzekutivi dhe legjislativi të gjitha janë të parapara edhe në kërkesën e MAPL-së që kane të bëjnë me buxhetimin e këtyre projekteve. Pjesëmarrja në konferenca investive është paraparë buxhet dhe presim që brenda vitit 2023 që kemi pjesëmarrje që të ftojmë investitor të huaj që të jene pjesëmarrës për t'i nxitur investimet përsëri në Komunën e Drenasit sepse kemi edhe një numër të investimeve që po kërkojnë të investojnë në Drenas. Sa i përket donacionti për pjesën e hartimit të studimit të fizibilitetit për 3 projekte përmes partneritetit publiko privat shumica e komunave bëjnë edhe bashkëpunime me partneritetin publiko privat dhe anëtaret e ekipit komunal përkatësisht prej drejtorive të cilat kanë punuar në këtë dokument strategjik 2020-2024 kanë paraqitur projekte të cilat janë të planifikuara me ketë projekt.

Meqë nuk pati diskutime tjera, kryesuesi hodhi në votim ketë pikë të rendin e ditës: prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, **(Për)** votuan 24 anëtar, kundër nuk pati, 5 abstenim, u miratua pika e dytë e rendit të ditës.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari,** hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës. **3. Propozim Vendim për caktimin e normave tatimore për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2023.**

**Shyqiri Bublaku, Drejtori i Financave-** sa i përket propozim vendim për caktimin e normave tatimore për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2023, është e rregulluar me ligjin e tatimit në pronën e paluajtshme që të behet përcaktimi për çdo vit kalendarit i normave tatimore, në propozim vendim i keni 9 kategori të cilat tatimohen me shkallet e

tatimit në pronë, dhe shkalla tek ne të cilën e kemi aplikuar dhe propozuar është shkalla më ë ulët deri më tani që e përcakton shumën e obligimeve që kanë me dal prej tatimit në pronë.

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime tjera kryesuesi hodhi në votim ketë pikë të rendin e ditës: prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, **(Për)** votuan 29 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua pika e tretë e rendit të ditës.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari,** hapi diskutimin për pikën e katert të rendit të ditës. 4. **Propozim Vendim për dhënien në shfrytëzim Afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të Pronës së Paluajtshme të Komunës të personit fizik juridik Limit Project shpk, "Rinesa" shpk në parcelën kadastrale : P-70314035-00004-124, zona kadastrale Komoran.**

**Azemine Bujupi-Gjoka,** Të nderuar qytetar, sot jemi mbledhur këtu që të tregojmë se pse kemi marr besimin qytetar. Siç jeni të shqetësuar ju në këto momente , shqetësimi është edhe brenda secilit nga ne, sepse sot, po tentohet të grabitet prona e komunës.
Muaji nëntor është muaji ku janë gdhendur datat më të rëndësishme të historisë sonë më të lavdishme kombëtare, prandaj sot nuk bënë assesi që datën 24 nëntor ta kujtojmë si datën e turpit tonë, nëse veprojmë me logjikën grabitqare.
Sot kemi momentin të gjithë ne si asamblist, si të zgjedhurit e qytetareve, me e dëshmu se sa parësor është vendi ynë, komuna jonë.

Sot unë e gjithë ne, opozitë e pozitë, duhet me u qu edhe me dal prej seance.
Po, me u qu edhe me dal.
Nuk na falet ky moment nëse qendrojmë e bëhemi kukulla për interesa të disa grabitqareve.
Nuk do na falet besoni, do të mbaheni mend me figura emër e mbiemër!
Ai'a vlen? Jo.

Drenasi është i të gjithëve . Është i të gjithë neve.
Po, asambleista të VV-së, ju të GREEN, LDK e AAK , por dhe ju të pozitës, qohuni bashkë me ne.
Qohuni dëshmojeni që nuk jeni me grabitqaret.

Thirrje për PDK-në mos e votoni, mos e votoni se po të ishte Kadri Veseli kryetar i PDK-së nuk do ta lejonte këtë gjë, nuk do të lejonte që ne kundërshtim me kërkesat e qytetareve të votohej kjo grabitje e pronës së tyre(qytetareve).
Qytetaret po ju shohin.
Qytetaret syt i kanë tek ne.
Qohuni.
Nese qëndroni, jeni duke u bërë pjesë e grabitjes, qoftë direkt apo indirekt.
Mos e bëjeni.
Le të tregojmë që ka njerëz që shohin me mendje të hapu për Drenasin kulturor, shoqëror e zhvillimor!
Le të tregojmë që mund të shihet Drenasi me syrin e pastert, e jo me syrin e grabitqareve.
Nga ky moment në shenjë revolte, me shenjë të protestës, në shenjë të mos pajtimittë kësaj kontrabande, ju ftoj të lëshoni seancën.
Drenasi nuk e meriton me u udhëheq nga kjo mendësi e ndërtesave e dostave, imagjinoni në zemren e e institucioneve tek gjykata , komuna e policia të behen ndërtesa banesore. Ndërsa ne si DD, kishim planifikuar që në atë vend ta bëjmë kompleksin kulturor, e cila do të ju shërbej të gjithë qytetareve brez pas brezi.

Ne ju paralajmerojmë se nëse ky vendim kalon sot, do të përdorim të gjitha format demokratike për të penguar zhvillimin e këtij projekti në dem të qytetareve. Qe nga protestat e deri në revoltë qytetare nëse është e nevojshme. Prandaj thirrni mendjes e mos u bëni krah i së keqes sepse nesër do ju gjykoj historia!

Pas këtij diskutimi grupi i asamblistëve të Partisë Demokratët për Drenasin lëshuan seancën.

**Arbër Halilaj,** Si bashkëthemelues i "**I.Q. GREEN PËR DRENAS**" dhe përfaqësues i juaji në Asamble, dola në foltore për tu deklaruar për çështjen e dhënies së pronave komunale në shfrytëzim afatgjatë, pikat 4 deri në 8.
Kolege e kolegë Asambleist,

Ta kemi parasysh që secili nga ne kemi ardhur këtu në Asamble me votat e qytetarëve që sot na përcjellin, prandaj nisur nga ky fakt duhet të dëgjojmë zërin e tyre dhe të prezentojmë interesat e tyre primare, e jo për interesa personale të kujtdo qoftë, të votojmë pro shëmtimit dhe degradimit të qendrës së qytetit.

Këto Propozim-vendime nuk përmbajnë destinimin as arsyetimin e interesit publik, qëllimin e zhvillimit ekonomik, punësimit të qytetarëve apo rritjen e mirëqenies së tyre, që do të duhej të sillte dhënia në shfrytëzim e këtyre pronave. Cili është interesi publik i qytetarit të Drenasit dhe i zhvillimit lokal ekonomik në këtë rast?

Pronat e mëhershme komunale të dhëna me koncesion për ndërtime, kanë rezultuar me banesa komunale të uzurpuara. Qytetarët e Drenasit kanë interesa, nevoja e kërkesa tjera zhvillimore e infrastrukturore.

Ne si GREEN e kemi kundërshtuar edhe Hartën Zonale Komunale për arsye të ngjashme, meqë është bërë pa pasur ndonjë planifikim nga ekspertët për zhvillim ekonomik në interes të qytetarëve, të shprehur pastaj në planin urbanistik.

Këto prona komunale po jepen në afatin maksimal 99 vite, ndërsa Ju njoftoj se në Komitetin për Politikë dhe Financa asnjëra nga pikat lidhur me dhënien e pronës komunale nuk kanë marrë votat që të diskutohen sot në seancë, prandaj jam kundër këtij degradimi dhe për të mos qenë pjesë e kësaj maskarade, e lëshoj këtë seancë dhe kërkoj që ky veprim imi gjithsesi të evidentohet në procesverbal.

Pas këtij fjalimi grupi i asamblesë GREEN për Drenasin lëshuan seancën.

**Florentina Elezi-Veliu,** Ashtu si ne mandatin e kalun, ashtu edhe ne komitetin për politikë dhe financa vota ime ka qenë dhe do jetë kundër, për dhënien në shfrytëzim të tokave pa shiku interesin e përgjithshëm.

Po ashtu në komitetin për poltike dhe financa, kemi qene 4 vota kunder dhe 2 pro, dmth qe ne komitet pikat nga 4-8 nuk kan kaluar, qe dmth nuk do kishte qene mire me ardh as ne seance!

Per mua interesi i pergjitshem do te thote ndertimi i ndonje qerdhe, shkolle, teatri, qender

kulturore, muze, salle kulture etj por asesi ndertimi i banesave per interese te ngushta personale!
Ne sallen e kultures ne objektin qe ju doni ta jepni per banesa jane mbajt seanca,takime,festivale, e organizime rinore te shumta, poashtu eshte qendra per promovimin e te drejtave te grave e cila bene nje pune te mrekullishme per te githa grate e Drenasit dhe jo vetem, kur keni marre vendimin per ta dhene kete parcela per interesa te ngushta a keni mendu se ku do te mbahen tani e tutje keto organizime?

Ju bej thirrje te gjithe kolegeve asambleist te zgjedhur nga votat e qytetareve tanë qe te mos votojne kunder interesit publik, po te ishin qytetaret te informuar sa duhet lidhur me keto vendime sot para objektit te komunës do te kishim qindra njerëz te grumbulluar ne mbrojtje te te mires publike, por nuk kane qene te informuar dhe kane halle tjera, sepse ju mungojne edhe kushtet elemenate per jete.

**Egzona Tërdevci,** që para se të dilte njoftimi për shpalljen e interesit për dhënien në shfrytëzim të këtyre pronave si asambleistë kemi pranuar informata se vec ishin ndarë përfituesit e parcelave që do të jipeshin në shfrytëzim, duke dashur të besojmë që ende ka mbet pak mundësi për transparencë e punë në interes të të mirës së përgjithshme nga komuna jonë vendosëm që të presim që të finalizohet ky proces që ne të mund të japim vlerësimin tonë, rezultati nuk ishte aspak befasues ashtu sic ishin dhënë premtimet në kohë fushate për mbështetësit e zotëri Lladrovci ashtu edhe po ju ndahen shpërblimet dostave të tij e përfituesve më të mëdhenj nga tenderët publik të komunës sonë.
Para se të trajtojmë pronat që janë dhënë e ato që nuk i plotësuan kriteret ju lutem ta sqaroni për publikun pse është heq parcela tek pishat në Gllobar nga dhënia në shfrytëzim meqë kur janë votuar pronat që do të jipen në shfrytëzim një nga pronat kanë qenë edhe më shumë se 40 hektarë të pishave në Gllobar,për sqarim ne jemi shumë të lumtur që ajo pjesë nuk është dhënë në shfrytëzim se duke pa vullnetin tuaj për investime që vec përfitim nuk I sjellin komunës nuk du as me mendu se kujt e për cfarë qëllimi do ti jepej në shfrytëzim ajo pjesë e pasurisë tonë publike.
Si grup i asambleistëve ne nuk jemi kundër zhvillimit ekonomik të qytetit tonë, jemi kundër që pasurinë tonë publike ta keqshfrytëzojnë disa individë që për shkak të afërsisë me kryetarin edhe ashtu janë shpërblyer mjaftueshëm nga komuna jonë.
I kemi parë me kujdes dokumentacionet e pranuara lidhur me këtë pikë, ne si asambleistë duke qenë të thirrur për të votuar vendimin që ka marrë komisioni përkatës për këto prona do të duhej të kishim më shumë informata rreth këtyre investimeve, unë kam kërkuar nga kryesuesi që ti kemi planet e biznesit për këto investime, nuk i kam pranuar me arsyetimin se mund të dorëzohen vetëm nëse kërkohet qasje në dokumente publike, e kam dorëzuar dje kërkesën duke kërkuar me mirësjellje që këto plane ti pranojmë para seancës por nuk i kemi pranuar ende, ju lutem ta keni parasysh rëndësinë e temës që po diskutojmë, bëhet fjalë për 5 parcela të komunës sonë të cilat do të jipen në shfrytëzim për 99 vite e për të cilat informatat janë tejet të mangëta.
Fakti që komisioni ka plotësuar me dorë ofertat nga investuesit e bën edhe më të vështirë këtë proces, shumë nga ofertat vështirë shihen se edhe për cfarë ideje të investimit bëhet fjalë, por edhe ato që shihen kanë vec një vlerë investimi, nr të punëtorëve e qera vjetore për komunën pa saktësuar se si do të ndryshoj nr i punëtorëve ndër vite e cilat janë pritshmëritë e bizneseve nga këto investime.
Nëse i trajtojmë ofertat veç e veç unë ende nuk po mundem me kuptu se cili është interesi publik e ekonomik i komunës që objekti i komunës së vjetër të shfrytëzohet për ndërtim të një objekti afarist banesor, ju lutem na ndriqoni edhe neve se ku qëndron pjesa e interesit publik këtu, unë nuk jam e fushës e mund të jem gabim por ndoshta ky objekt ka mund të renovohet

për tu shfrytëzuar për interes publik të komunës-si vend për shtëpi kulture, salla që mund të i duhen komunës, zyrë për Kvrl e organizata tjera që angazhohen në interes publik por asesi nuk e kuptoj si i shërben interesit publik ndërtimi i një objekti afarist banesor ku do të rriten edhe më shumë fitimet e atyre që vec e kanë shfrytëzu në maksimum buxhetin e komunës sonë, nëse ndalemi tek pjesa teknike ky investim nuk sjell vende të punës përvec kohës gjatë ndërtimit.
Ju lutem shikojeni planin e biznesit, krejt dy faqe plan.
Super përfituesi i tenderëve të komunës sonë kompania Fer Petrol po merr pronë publike për 99 vjet me një përfitim për komunën gjithsej 396 mijë euro, aq sa shihet nga aplikacioni me qëllim të ndërtimit të pompes dhe deposë për ushqim, ju lutem a na shpjegoni se si ka mundësi që në të njëjtën sipërfaqe me një pompë të jetë një depo për ruajtje të ushqimit?

Tek Prona në zonën kadastrale Komoran, P-70314035-0981-0 në sipërfaqe prej 3263 metër katror, përfitim më të lartë të qerasë vjetore sesa Blerim Kluna ka ofruar Musa Binaku, me cfarë arsye i është dhënë parcela z.Kluna duke qenë se për komunën do të ishte më e leverdishme të jipet për z.Binaku?

Sa I përket pronave që nuk janë dhënë në shfrytëzim, dy në Gllobar dhe 4 në Komoran, sipas komisionit dy pronat në Gllobar do të shpallen sërish cka me pronat në Komoran?
Lidhur me pronat në Gllobar a janë lajmëruar palët paraprakisht se nuk duhet të jenë duke punuar gjatë kohës së shpalljes së interesit për këto prona?
Për fund duke parë gjithë këto paqartësi dhe vërejtje për këtë proces si grup i asambleistëve nga Lëvizja Vetëvendosje!, ne nuk do të votojmë për këtë degradim që po i bëhet pasurisë publike. E lëshojmë seancën për ketë pikë.

Pas këtyre diskutimeve grupi i asamblistëve të Partisë së Lëvizjes Vetëvendosje lëshuan seancën.

**Beqir Kiqina,** unë mendoj se asamblistët nuk duhet lëshuar seancën mund te votojnë për, kundër apo abstenim, ne i kemi kundërshtuar gjithnjë deri më tani për leje ndërtimi sot i kemi 5 propozim vendime me i votu dhe me iu dhënë leja dhe me qarkullu afarizmi në Drenas, mundemi me qenë kundër një pike të caktuar, mirëpo me qenë kundër investimeve në Drenas me të vërtetë është keq, gjithë ata që u larguan nga seanca i kemi votuar planin, hartën zonale për me ardh me investua në Drenas, i kemi votuar strategjitë për zhvillim, pse ne mos me investua, pse mos me iu dhënë prona, vetëm a është në rregull me ligj dhe a munden me u ndërtua Drenasi, ne të gjithë kemi qenë për investime në qytetin tonë dhe sot e lëshojmë sallën. Unë mendoj se duhet me e mbështet, ju bejë thirrje gjithë atyre që kanë dalur nga seanca të kthehen dhe të votojnë, mundemi me qenë për pika të caktuara kundër.

**Valentina Leku,** Sot një nga pikat shumë të rëndësishme është propozim vendimi për dhënien në shfrytëzim pronën e komunës së vjetër.
Në seancën e kaluar unë kam votuar pro për këtë propozim vendim, sepse jam për ndërtimin e qytetit ton, siç jam pas akuzave të mia të mëparshme për mos ndërtimin e qytetit tonë, pikërisht sot, jam për ndërtimin e qytetit tonë.
Pra pyetja ime për kryetarin është a do të ketë sallë të kulturës, bibliotekë të leximit, pa të cilat qyteti ynë do të ishte i varfër.
Nëse edhe këto janë pjesë e këtij ndërtimi atëherë unë jam pro këtij propozim vendimi.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci,** ne sot kemi para vetes zhvillimin e Komunës së Drenasit, po fillojmë nga projekti tek komuna e vjetër, ju e keni shikuar se çfarë gjendje ka qenë rreth komunës së vjetër, objekte të cilat kanë rrezikuar çdo moment dhe çdo kohë jetën e fëmijëve dhe qytetareve tanë, ne tani i kemi pastruar ato objekte të cilat janë dashur më u pastru vite më parë. Komuna e vjetër, ne e kemi një objekt i cili po rrezikon për qdo ditë shembjen e tij, po rrezikon shembjen për shkak edhe të vjetërsisë se tij, dhe është i ndërtuar me shtylla druri dhe kanë filluar me u kalb, ky kuvend ka dhënë miratimin për heqjen apo lirimin e objektit të komunës se vjetër, ne pa dashtë me ia hargju asnjë cent taksa paguesve tanë, ky kuvend ka marrë vendim që atë pronë me e dhënë në shfrytëzim për 99 vjet për të mirën e përgjithshme të komunës tonë. Objekti që do të ndërtohet nëse vendosni me e dhënë në shfrytëzim këtë pronë, janë disa aksionar që janë bërë bashkë të komunës tonë dhe sigurisht që unë i gezohna që në komunën tonë ka njerëz që kanë mundësi e kapacitet me e bërë një objekt i cili kish me i dhënë se pari mundësi e zhvillim komunës tonë dhe kish me u vendos i cili kish me dhënë jo vetëm shërbime qytetareve por kish me iu dhënë edhe pamje të mirë vendit. Ketë zonë komuna me 27 % do të fitoj sallën e re të kulturës, do të fitoj objekte administrative për nevoja të komunës. Ju e dini që ne në këtë objekt nuk kemi mundësi të zhvillimit për shkak se është objekt me kapacitet të vogël dhe ne nuk kemi vende të mjaftueshme për zyrtaret tanë. Ky objekt do të ketë mundësi për salla kulture, salla biblioteke, do të këtë gjithçka që i nevojitet institucionit publike të komunës tonë, pra komuna do të përfitoj mbi 5 mijë e 600 metra objekt administrativ, asnjë metër për banim nuk e merr komuna, pra e gjithë pjesa e objektit do të jete në shërbim të qytetareve të komunës tonë, shërbim të institucioneve të komunës tonë, edhe ne kemi deshirë me e ndertu objektin vet me buxhet tonin mirëpo derisa nuk i kemi kry edhe shumë shërbime tjera për qytetaret tanë ne nuk kemi mjete me i nda për me e ndertu objekt tonin në pronën e komunës, prandaj jemi të detyruar me i hap rrugë zhvillimit por edh e me pas kapacitet për komunën tonë për institucionet e komunës tonë. Ju ftoj këdo që ka ide më të mira me ardh me i diskutua me neve dhe jo me e lshu sallën sepse edhe vota kundër është normale, sepse ne e zvarrisim një zhvillim të Komunës së Drenasit dhe nuk ka pas asnjë gjë të keqe me marrë pjesë në seancë sepse qytetari i ka votu më marrë vendime, me marr vendim është edhe me votu kundër ne qeft se ne i kemi idetë e gabuara. Parcela e cila është në proces edhe pse nuk kemi korum mbledhja do të vazhdoj sepse pa votu Për apo kundër nuk përfundon mbledhja sepse ka hy në rend dite. Parcela në Qikatovë të Re do të do të punësoj 51 punëtor, ajo vetëm se i jep një mundësi të mirë të rinjeve i jep edhe një pamje të mirë, ne nuk i përcaktojmë bizneseve se qka dojna ne me ndertu ata ndertojnë biznes të vetin të cilët edhe e kanë biznesin e ndarë. Parcela në Komoran punëson 50 punëtor, një fabrikë e cila do të ishte për përpunimin e mishit. Nuk mund të marrë dikush pronë nëse nuk i ka plotësua kriteret. Parcela tjetër në Komoran ofron punësimin e 50 punëtoreve, nuk e ceka se sa qira do të marrë komuna, parcela në Qikatovë 4 mijë euro në vit, parcela në Komoran për fabrik të përpunimit 2 mijë euro, parcela tjetër në Komoran fabrik për përpunimin e dyreve dhe dritareve për më i dërguar jashtë vendit 2400 €, parcela Kadastrale në Korrotice të Eperme 55 punëtor dhe me qira prej 3165 €. Vlera e gjithë këtyre investimeve shkon nga 6 milion në 10 milion dhe numri i të punësuarve mbi 207 njerëz. Pra sot po ikim nga e drejta e votimit Për apo kunder pa asnjë arsye dhe me premtime koti. Prandaj unë i kërkoj kryeasuesit me mbyll seancën nëse nuk ka dikush tjetër për diskutim sepse nuk kemi shku ende të pika e votimit për me pas korum dhe i ftoj ta shtyni mbledhjen të shkojmë më pauzë dhe i lusim koleget tonë të cilët nuk kanë kërkesa apo ankesa të kthehen në kuvend me i votu pikat e rendit të ditës me e votu zhvillimin e komunës, i falënderoj Beqir Kiqinen, Egzon Qorri dhe Muhamet Kurtaj nga opozita që qëndruan në sallë dhe nuk e lëshuan seancën.

**Albulena Saliuki,** të nderuar qytetar vota juaj na ka sjellë në këtë kuvend dhe kemi marrë besimin për të ju përfaqësuar juve në mënyrën më të mirë. Këtë e kemi përgjegjësi dhe jo t'i ikim përgjegjësisë duke lëshuar seancën. Pikat e rendit të ditës janë për zhvillimin e përgjithshëm të komunës tonë dhe ku do të këtë edhe të punësuar gjë e cila është shumë e nevojshme për Komunën tonë, ata të cilët janë kundër lë të votojnë kundër apo të abstenojnë kjo është e drejtë e secilit prej neve por nuk kemi të drejt t'i ikim përgjegjësisë duke lëshuar seancën jemi këtu për interes të përgjithshëm andaj i ftoj të gjithë ata që e kanë lëshuar seancën le të kthehen në seancë dhe të vazhdojmë seancën për interes të përgjithshëm të Komunës së Drenasit.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari,** njoftoj asamblistët se nuk kemi kuorum të mjaftueshëm për arsye se 16 anëtar të asamblesë komunale lëshuan seancën, 13 anëtar mbeten ne sallë ndërsa 2 anëtar munguan: z.Jahir Hajdari dhe Mërgim Pirraku, në mungesë kuorumi mbledhja u ndërpre dhe shkoj në pauz deri në një njoftim të radhës.

Mbledhja u ndërpre rreth orës 11:50 min.

Rendi i ditës u miratua me 10 pikat e lartcekura më lartë, prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, **(Për)** votuan 20 anëtar, 9 vota kundër, abstenim nuk pati, ndërsa në këtë mbledhje u miratuan vetëm tri pikat e para të rendit të ditës, dhe pas kësaj 16 anëtar të asamblesë komunale lëshuan seancën, 13 anëtar mbeten në sallë ndërsa 2 anëtar munguan, dhe në mungesë kuorumi mbledhja u ndërpre dhe shkoj në pauzë deri në një njoftim të radhës.

**Kryesuesi Milaim Hajdari** bëri një njoftim me shkrim dhe me protokoll: 02.070/03-61273 dt. 24.11.2022 dhe u publikua në ueb faqen zyrtare të Komunës së Drenasit për vazhdimin e Mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit, të mbajtur më 24.11.2002, e cila u ndërpre për mungesë kuorumi, do të mbahet në ditët në vazhdim.
Për datën dhe orën e vazhdimit të Mbledhjes së rregullt, me pikat e Rendit të ditës, do t'ju njoftojmë me kohë.

Pas kësaj u bë njoftimi nga kryesuesi se mbledhja do të vazhdoj me datë:
21.12.2022. Vazhdimi i mbledhjes se ndërprerë të datës 24/11/2022, nuk filloj për shkak të mungesës se kuorumit as me dt. 21.12.2022.

Por edhe pas kësaj u bë njoftimi nga kryesuesi se mbledhja do të vazhdoj me datë 28.12.2022 në ora 14:00.
Vazhdimi i mbledhjes se ndërprerë të datës 24/11/2022, nuk filloj për shkak të mungesës se kuorumit as me datë 28.12.2022.

Pas kësaj prapë kryesuesi beri njoftimin se mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal e ndërprerë në mungesë kuorumi më datë 24/11/2022,e cila po ashtu nuk u vazhdua me datë 21/12/2022 dhe as me datë 28/12/2022 në mungesë kuorumit, vazhdon me datë 30/12/2022 në ora 10:00. Por mbledhja nuk filloj për shkak të mungesës se kuorumit as me datë 30.12.2022.

**Njoftimi** nga Kryesuesi i Kuvendit Milaim Hajdari- Pas pranimit të shkresës së Kryetarit të Komunës së datës 04.01.2023, ( të cilën e gjeni të bashkangjitur në email) lidhur me tërheqjen nga rendi i ditës të pikave të papërfunduara të mbledhjes së datës 24.11.2022, në pajtim me nenin 47 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe nenit 9 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2015 për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, ju njoftojë se pikat e papërfunduar janë tërhequr nga rendi i ditës, rrjedhimisht mbledhja e datës 24.11.2022 konsiderohet e përfunduar.

*Me gjerësisht, mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Drenasit të datës 24.11.2022 mund të ndiqni në ueb faqen zyrtare të komunës, rrjetin social të Fecebook-ut dhe në kanalin YouTube.*

Procesmbajtëse:
Liridona Fejza-Ajazi

Kryesuesi i Kuvendit Komunal
Milaim Hajdari

Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës

02 Nr. 060/01-3830 dt. 18.01. 2023

**PROCESVERBALI**

I mbledhjes se jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal të Drenasit të mbajtur më datë: **28.12.2022**

**Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Komunal-Milaim Hajdari**

**Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 16 anëtarë.**
Kuvendi filloi punimet më këtë :

Rend dite

1. Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit 02. Nr. 464/01-18364 të datës 27.04.2022, të Kuvendit të Komunës së Drenasit.
2. Plani i Punës së Kuvendit Komunal për vitin 2023.
3. Plani vjetor i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2023.
4. Plani Komunal për Integritet 2023-2026.
5. Lista e rreziqeve Komunale për vitin 2023.
6. Propozim vendim për emërtimin e Ndërmarrjes Publike Lokale (NLP) në Drenas.
7. Informimi i Kuvendit për aktivitetet e KKSB-së për gjashtë mujorin e dytë.
8. Propozim vendim për miratimin e raportit të komisionit komunal përfundimtar për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

Të mërkurën me dt. 28.12.2022 është mbajtur mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Drenasit, ku për diskutim ishin 7 pika për rend dite.
Mbledhja është kryesuar nga kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari, ndërsa merrnin pjesë, Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, nënkryetari Arben Shala, drejtor të drejtorive komunale, anëtarët e Kuvendit, zyra e informimit, përfaqësues të KFOR-it, përfaqësues të Mediave. Në mbledhje morën pjesë vetëm 16 anëtar të asamblesë Komunale, ndërsa munguan 15 anëtar të Kuvendit Komunal, mungoi: Arbër Halilaj, Arigon Sinani, Azemine Bujupi-Gjoka, Filloreta Bujupi, Bekim Lestrani, Hamit Haxhiu, Hamit Kastrati, Jahir Hajdari, Labinot Halilaj, Malsore Cakiqi, Marigona Bazaj, Mehedin Salihu, Mërgim Pirraku, Mirlinda Dvorani, Sali Dvorani.

Më poshtë ju elaborojmë pikat që janë diskutuar e miratuar me shumicë votash në mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari**- pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit njoftoi me rendin e ditës anëtaret e Kuvendit Komunal.

**Egzona Tërdevci,** i përgëzoj që i keni marrë parasysh rekomandimin tonë që mbledhja e kaluar e seancës se jashtëzakonshme nuk është thirr në përputhje me ligjin e vetëqeverisjes lokale e as me udhëzimin administrativ e MAPL-së për thirrjen e mbledhjeve të Kuvendit të komunës, tek pika e 8-të propozim vendim për miratimin e raportit të komisionit komunal përfundimtar për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, ne nuk kemi marrë material nga komisioni për vlerësimin e dëmeve, nuk besoj që mundemi me votu për diçka që nuk e dina se si është vlerësua, propozoj që kjo pikë të shtyhet për një mbledhje tjetër.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci,** i falënderoj për pjesëmarrje në këtë mbledhje kaq të rëndësishme sot për komunën e Drenasit, ku 6 prej tyre vlerësohen edhe për grand të përformances. Pika e tetë propozim vendim për miratimin e raportit të komisionit komunal përfundimtar për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, është një pikë të cilën komisioni e ka bërë vlerësimin e dëmeve, e kemi dërgua në ministri, pastaj qeveria e ka nxjerr një vendim tjetër dhe ne për shkak të kohës qytetareve me iu ardh në ndihmë, ato janë vlerësime që i ka bërë komisioni nuk i kemi bërë ne, mirëpo është edhe një komision qeveritar që e bënë vlerësimin.

Meqë nuk pati diskutime tjera, kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës: prezent gjatë votimit ishin 16 anëtar, **(Për)** votuan 16 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua rendi i ditës.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari,** hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1. Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit 02. Nr. 464/01-18364 të datës 27.04.2022, të Kuvendit të Komunës së Drenasit.**

**Egzona Tërdevci,** këtë vendim ne si grup i asamblistëve e kishim kundërshtuar parimisht në seancën e dt. 27.04.2022 gjithherë duke pas parasysh interesin e përgjithshëm të komunës dhe qytetarëve tanë, një vendim të tillë edhe ministria e Planifikimit Hapësinor e ka vlersu të jashtëligjshëm për faktin se një kompetencë e tillë me ligj për shpronësim i takon kryetarit të komunës, kuvendi nuk ka ndonjë rregullore tjetër lidhur me këtë çështje. Janë dy çështje që nuk i kam kuptuar në këtë pjesë, vlerësimi i ligjshmërisë në ketë rast i mos ligjshmërisë është konstatuar që vendimi është në kundërshtim me ligjin, e cila është dhënë në maj të këtij viti,

nëse kuvendi komunal e ka marrë këtë vendim qysh në maj pse u dashtë 7 muaj për me e prit për me e sjellë shfuqizimin e këtij vendimi dhe nëse një kompetencë e tillë i takon kryetarit të komunës, cila është arsyeja që një vendim i tillë me shku përmes asamblesë apo është frik nga marrja e përgjegjësisë.

